



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1800/6 prot.

Datë 05/10/2022

V E N D I M

Nr. 969/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguri	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05/10/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF- 27103-04-28-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për *Forcat e Armatosura, ndarë në 8 (tetë) Lote si më poshtë*” me fond limit 254.357.470 lekë pa TVSH Loti 3 me Nr. REF- 27109-04-28-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë.*”, me fond limit 24.682.600 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK
Adresa: Rruga “Beqir Luga”, Pallati nr.3, Sh 1/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Silver” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga “Bajram Curri” Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-rë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.04.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF- 27103-04-28-2022, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Forcat e Armatosura,

ndarë në 8 (tetë) Lote si më poshtë” me fond limit 254.357.470 lekë pa TVSH Loti 3 me Nr. REF- 27109-04-28-2022, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë.”, me fond limit 24.682.600 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datë 30.05.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.08.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- “Silver” SHPK	23.185.000 leke	kualifikuar
- “SORI-AL” SHPK	24.258.727 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 15.08.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 111 të Agjencisë së Prokurimit Publik. Sipas këtij njoftimi, operatori ekonomik “Silver” SHPK është shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 19.08.2022 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më datë 18.08.2022 ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1800/2, datë 19.08.2022 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SORI-AL” SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përfundim të afatit ligjor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1800/3 prot, datë 06.09.2022 “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1431/1 prot, datë 09.09.2022 me objekt: “Kthim përgjigje”, drejtuar KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1800/4 prot, datë 13.09.2022, autoriteti kontraktor

informon se referuar përcaktimeve të nenit 114, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” ka ndërprerë afatin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK, pasi është duke verifikuar një nga dokumentat objekt ankimimi të ankesës nr. 1331 prot, datë 19.08.2022 të paraqitur nga ofertuesi “SORI-AL” SHPK.

II.9. Me shkresën nr. 1467 prot, datë 14.09.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 3 ‘Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr. 5004 9QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë’ “, drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 1800/5 prot, datë 15.09.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK, si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik “SORI-AL” shpk ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit “SILVER” SHPK, për mospërmblidhjen e kriterit të përcaktuar në pikën 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentat e tenderit, ku përcaktohet: “1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim te rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

<i>Nr.</i>	<i>Vendodhja</i>	<i>Statusi</i>	<i>Nr. i regjistrimit te posacem</i>
<i>1</i>		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	
<i>Etj.</i>		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	

Detyrimisht cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per cdo stabiliment (ne ponesi dhe/ose qira).”, me pretendimin si vijon: “Operatori ekonomik “Silver ” SHPK nuk ka deklaruar stabilimentet që disponon sipas kërkesës së seksionit 2 “Kritere të veçantat të kualifikimit”, pika 2.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomike”, nënpika 1, paragrafi 1.1 “Shënim 1.1 ” dhe “Shënim 1.2”.

Për procedurën e prokurimit -Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datë 09.08.2022, ka bërë vlerësimin si vijon:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT / NUIS	Vlera e Ofertës, lekë (pa TVSH)	Renditja
	SILVER” SHPK	K88010301S	23,185,000	Vendi i parë
	SORI-AL” SH.P.K	K 31510059 D	24,258,727	Vendi i dytë

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin nr.3 dt 09.08.2022, “Për vlerësimin e ofertave”, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimes “SORI-AL” shpk, dhe konstatoi:

Në dokumentat e tenderit, në pikën 1, seksioni 2.1, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, përcaktohet se; “1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim te rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrit te posacem
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per cdo stabiliment (ne ponesi dhe/ose qira).”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesi “Silver” SHPK, konstatoi se ky ofertues për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur dokumentacionin me emërtim “Deklaratë Stabilimentesh”. Me anë të këtij dokumenti, ky ofertues deklaron: Disponojmë stabilimentet si më poshtë:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrit te posacem
1	VLORE	Qera	LN-1454-11-2020

Marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes “Sori-Al” SHPK, Komisioni i shqyrtimit të Ankesave, iu drejtua me shkresë Bashkisë së Vaut të Dejës, duke kërkuar informacionin si më poshtë:

- A ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit shoqëria “SILVER” SHPK për ambientet e Azilit, Qendra Sociale “Besa” Barbullush.

- Nëse po, cila është vendodhja e stabilimentit?

Në datë 12.09.2022 "Bashkia Vau i Dejës" ka kthyer përgjigje si vijon: "Në përgjigje të shkresës suaj... ju bëjmë me dije se aktualisht, shoqëria "Silver" shpk, nuk ka kontratë të lidhur me Bashkinë Vau Dejës. Shoqëria SILVER shpk ka ushtruar më parë aktivitet pranë Bashkisë Vau Dejës, por marrëveshja kuadër ka mbaruar në muajin qershor 2022.

Theksojmë se procedura e prokurimit objekt ankimi është zhvilluar në datë 30.05.2022, ndërkohë operatori ekonomik "SILVER" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin në SPE në datë 28.05.2022.

Për sa më sipër rezulton se në momentin e plotësimit dhe dorëzimit në SPE të dokumentacionit lidhur me kriterin e kualifikimit objekt ankimimi, operatori ekonomik "SILVER" SHPK ka ushtruar aktivitetin e shërbimit dhe gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit në këtë bashki.

Stabilimenti i sipërcituar nuk është pasqyruar nga ofertuesi në deklaratën së tij lidhur me disponimin e stabilimenteve dhe regjistrimin e tyre.

Në ligjin nr.9863, datë 26.03.2013, i ndryshuar, në pikën 34, neni 3 "Përkufizime", përcaktohet: " "Stabiliment" është çdo mjedis, ku zhvillohet biznesi ushqimor dhe/ose biznesi ushqimor për kafshë " dhe në pikën 2 të këtij neni: "Biznes ushqimor" është çdo veprimtari e ndërmarrë për qëllime përfitimi ose jo, publike ose private, për prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimit."

Në nenin 19, pika 1, deri në pikën 7, të po këtij ligji është përcaktuar: "1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 5. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi. 6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.. 7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri."

Referuar legjislacionit të sipërcituar, çdo mjedis në të eilin zhvillohen veprimtaritë për prodhimin, përpunimin apo shpërndarjen e ushqimit kanë detyrimin të regjistrohet në regjistrin e Ministrinë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Organi qendror blerës gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues të përgatisë dhe të dorëzojë ofertat në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në fazën e vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shënimin 1.1 të pikës 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentat e tenderit, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Në fazën e vlerësimit të ofertave. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi, vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Bazuar në pikën 2, të nenit 82, të VKM-së 285/2021, ku përcaktohet: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”, ofertuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga organi qendror blerës, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Sori-AL” shpk qëndron.

Në mbështetje të pikës së parë të këtij vendimi, ku theksojmë se gjendja faktike juridike pas arsytimit të Konkluzionit të Shqyrtimit të Ankesave për ofertuesin “SILVER” SHPK do të jetë e skualifikuar, pasi bazuar në pikën 2, të nenit 82, të VKM-së 285/2021, ku përcaktohet: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.” mos përmbushja qoftë edhe një kërkesë për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit do të jetë kusht për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me arsyet e tjera të kualifikimit, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi në mbështetje të bazës ligjore të sipërcituar edhe në hipotezën që këto pretendime do të qëndronin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurirni, si rrejdhim këto pretendime nuk do të shqyrtohen.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

Vendosi

1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ‘SORI-AL’ SHPK për procedurën e prokurimit, për Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë” me fond të marrëveshjes kuadër 24,682,600 Lekë (pa TVSH), me numër reference të Lotit 3, REF-27109-04-28-2022.

2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.”.

II.11. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 1331/3 prot, datë 14.09.2022, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës lidhur me pretendimet e ankimuesit ja ka komunikuar shoqërisë ‘Silver’ SHPK, ku kjo e fundit sipas informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor nuk rezulton që të ketë paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues ‘SORI-AL’ SHPK mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ‘Silver’ SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 1467 prot, datë 14.09.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 3 ‘Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr. 5004 9QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë’ “, drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 1800/5 prot, datë 15.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ‘SORI-AL’ SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik ‘SORI-AL’ shpk ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit ‘SILVER’ SHPK, për mospërmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentat e tenderit, ku përcaktohet: “1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë ‘II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz’ të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per këte arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrit te posacem
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per cdo stabiliment (ne ponesi dhe/ose qira).”, me pretendimin si vijon: “Operatori ekonomik ”Silver ” SHPK nuk ka deklaruar stabilimentet që disponon sipas kërkesës së seksionit 2 “Kritere të veçantat të kualifikimit”, pika 2.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomike”, nënpika 1, paragrafi 1.1 “Shënim 1.1 ” dhe “Shënim 1.2”.

Për procedurën e prokurimit -Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datë 09.08.2022, ka bërë vlerësimin si vijon:

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomik	NIPT / NUIS	Vlera e Ofertës, lekë (pa TVSH)	Renditja
	SILVER” SHPK	K88010301S	23,185,000	Vendi i parë
	SORI-AL” SH.P.K	K 31510059 D	24,258,727	Vendi i dytë

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin nr.3 dt 09.08.2022, “Për vlerësimin e ofertave”, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimes “SORI-AL” shpk, dhe konstatoi:

Në dokumentat e tenderit, në pikën 1, seksioni 2.1, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, përcaktohet se; “1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim te rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrit te posacem
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per

ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Per ushqimin".

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per cdo stabiliment (ne ponesi dhe/ose qira)."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga ofertuesi "Silver" SHPK, konstatoi se ky ofertues për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur dokumentacionin me emërtim "Deklaratë Stabilimentesh". Me anë të këtij dokumenti, ky ofertues deklaroi: Disponojmë stabilimentet si më poshtë:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit te posacem
1	VLORE	Qera	LN-1454-11-2020

Marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Sori-Al" SHPK, Komisioni i shqyrtimit të Ankesave, iu drejtua me shkresë Bashkisë së Vaut të Dejës, duke kërkuar informacionin si më poshtë:

- A ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit shoqëria "SILVER" SHPK për ambientet e Azilit, Qendra Sociale "Besa" Barbullush.
- Nëse po, cila është vendodhja e stabilimentit?

Në datë 12.09.2022 "Bashkia Vau i Dejës" ka kthyer përgjigje si vijon: "Në përgjigje të shkresës suaj... ju bëjmë me dije se aktualisht, shoqëria "Silver" shpk, nuk ka kontratë të lidhur me Bashkinë Vau Dejës. Shoqëria SILVER shpk ka ushtruar më parë aktivitet pranë Bashkisë Vau Dejës, por marrëveshja kuadër ka mbaruar në muajin qershor 2022.

Theksojmë se procedura e prokurimit objekt ankimiini është zhvilluar në datë 30.05.2022, ndërkohë operatori ekonomik "SILVER" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin në SPE në datë 28.05.2022.

Për sa më sipër rezulton se në momentin e plotësimit dhe dorëzimit në SPE të dokumentacionit lidhur me kriterin e kualifikimit objekt ankimiini, operatori ekonomik "SILVER" SHPK ka ushtruar aktivitetin e shërbimit dhe gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit në këtë bashki.

Stabilimenti i sipërcituar nuk është pasqyruar nga ofertuesi në deklaratën së tij lidhur me disponimin e stabilimenteve dhe regjistrimin e tyre.

Në ligjin nr.9863, datë 26.03.2013, i ndryshuar, në pikën 34, neni 3 "Përkufizime", përcaktohet: " "Stabiliment" është çdo mjedis, ku zhvillohet biznesi ushqimor dhe/ose biznesi ushqimor për kafshë " dhe në pikën 2 të këtij neni: "Biznes ushqimor" është çdo veprimtari e ndërmarrë për qëllime përfitimi ose jo, publike ose private, për prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimit. "

Në nenin 19, pika 1, deri në pikën 7, të po këtij ligji është përcaktuar: "1. Stabilimentet për prodhimin primar të ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 2. Stabilimentet për prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e ushqimeve regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 5. Stabilimentet për përgatitjen, përpunimin dhe trajtimin e ushqimit, ku përfshihen hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme (kioska ushqimi, stacionare ose të

lëvizshme, vende shitjeje në treg, mjete motorike për shitje) regjistrohen në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pezullon përkohësisht apo i propozon ministrit revokimin e licencës, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji. Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. 5. Stabilimentet, të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe depozitojnë ushqime me origjinë shtazore, miratohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit veterinar në fuqi. 6. Stabilimentet, të cilat janë në procesin e miratimit, nuk e fillojnë veprimtarinë pa autorizimin përkatës. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit regjistron vetëm ato stabilimente, që i janë nënshtruar kontrollit të vlerësimit për plotësimin e kushteve.. 7. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në përfundim të procedurës së regjistrimit në regjistrin e vet, i jep zyrtarisht çdo stabilimenti, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, një numër regjistri.”.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, çdo mjedis në të eilin zhvillohen veprimtaritë për prodhimin, përpunimin apo shpërndarjen e ushqimit kanë detyrimin të regjistrohet në regjistrin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Organi qendror blerës gjykon se është përgjegjësi e operatorit ekonomik ofertues të përgatisë dhe të dorëzojë ofertat në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në fazën e vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shënimin 1.1 të pikës 1 seksioni 2.1 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në dokumentat e tenderit, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Në fazën e vlerësimit të ofertave. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi, vetëm mbi kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Bazuar në pikën 2, të nenit 82, të VKM-së 285/2021, ku përcaktohet: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”, ofertuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga organi qendror blerës, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Për sa më sipër, pretendimi i ankimesit “Sori-AL” shpk qëndron.

Në mbështetje të pikës së parë të këtij vendimi, ku theksojmë se gjendja faktike juridike pas arsyetimit të Konisionit të Shqyrtimit të Ankesave për ofertuesin “SILVER” SHPK do të jetë e skualifikuar, pasi bazuar në pikën 2, të nenit 82, të VKM-së 285/2021, ku përcaktohet: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.” mos përmbushja qoftë edhe një

kërkese për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit do të jetë kusht për skualifikimin e ofertës së operatoriit ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me arsyet e tjera të kualifikimit, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi në mbështetje të bazës ligjore të sipërcituar edhe në hipotezën që këto pretendime do të qëndronin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurirni, si rrejdhim këto pretendime nuk do të shqyrtohen.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

Vendosi

1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ‘SORI-AL’ SHPK për procedurën e prokurimit, për Lotin 3 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë” me fond të marrëveshjes kuadër 24,682,600 Lekë (pa TVSH), me numër reference të Lotit 3, REF-27109-04-28-2022.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Duke ju falenderuar pëi mirëkuptimin.”.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe

rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të

interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF- 27103-04-28-2022, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Forcat e Armatosura, ndarë në 8 (tetë) Lote si më poshtë” me fond limit 254.357.470 lekë pa TVSH Loti 3 me Nr. REF- 27109-04-28-2022, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak Nr.5004 (QAPN), Zall-Herr, Qendër Tiranë.”, me fond limit 24.682.600 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri